



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 TË BASHKISË SHKODËR”

Konsultim publik : Rajoni nr.2.

Data : 18.09.2025

Ora : 13.00

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 26, nga të cilat 8 gra.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2026-2028 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Zv.Kryetari i Bashkisë Z.Alban Preka, i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fillimisht fjalën e merr Z.Rubin Borshi, administrator i Rajonit nr.2 i cili bën një përmbledhje të punëve dhe investimeve të kryera për lagjen nr.2 të qytetit.

Më pas fjalën e merr Zv.Kryetari i Bashkisë, **Z. Alban Preka**, i cili falënderon pjesëmarrësit për angazhimin. dhe fton të pranishmit që të trajtojnë nevojat dhe problematikat e zonës së tyre, në mënyrë që për vitin tjetër të kemi mundësinë të ndërhyjmë dhe të planifikojmë buxhetin sipas prioriteteve dhe emergjencave në këtë rajon. Ai siguron qytetarët që çdo gjë do mbahet shënim dhe do reflektohet në proces verbalin e këtij takimi duke u trajtuar më pas nga strukturat e Bashkisë Shkodër.

Z. Fatmir Dekovi, banor i rrugës Partizani :

- Vetëm 50 metra larg Tregut Rus, kemi një rrugicë rreth 70 – 80 metra në një gjendje të shkatërruar. Kemi vite që vijmë në dëgjesa dhe akoma asnjë ndërhyrje.
- Shtyllat e energjisë elektrike janë të vjetra dhe mund të ndodh një tragjedi po nuk u ndërhy. Duhet komunikuar me OSHEE-në.

Nga ana e Bashkisë sqaron **Z.Borshi** duke thënë se vërtetë situata e kësaj rruge është problematike. Në dy raste që kemi dashur të ndërhyjmë me FSHZH për të bërë asfaltimin është parë e pamundur sepse është rrugicë pa kanalizime. Por do jetë patjetër prioritet që të përfshihet në investim kjo rrugë.

Kurse në lidhje me shtyllat e energjisë elektrike **Zv. Kryetari Preka** shprehet se ankesat tuaja do dërgohen pranë OSHEE-së.

Znj. Fatmira Hoxhaj, banore Lgj. “Partizani”, rruga “Komane”:

- Rruga për tek Shkolla “Zani I Shkodrës” është në gjendje skandaloze, e pakalueshme. Ju jeni në dijeni që asaj rruge ndriçimin e asfaltimin ia kemi bërë vetë para disa vitesh. Por duhen ndërhyrja e Bashkisë sepse kjo rrugë ka nevojë edhe për kanalizime. Flas si përfaqësuese e shkollës ,dhe u bënë vite tashmë ëe ajo rrugë është me këto problem. Gjatë gjithë periudhës së shkollës për të gjithë nxënësit dhe fëmijët është e pamundur të vihet në shkollë. Është shumë urgjente ndërhyrja në këtë rrugë.

Z.Borshi sqaron se kur kemi qenë duke filluar investimin në këtë rrugë, ka inicuar një problematike pronësie aty. dhe pa u zgjidhur problematika e pronësisë nuk mund të ndërhyhet. Megjithatë rruga për të cilën bëhet fjalë mbetet prioritet për ne dhe do të ndërhyjmë sa më shpejt të mundemi.

Edhe **Z. Altin Salihi** thotë se është rrugë që e kemi në vëmendje dhe së shpejti do të ndërhyjmë dhe do të jetë në buxhet për vitin tjetër.

Po ashtu edhe **zv. Kryetari Z.Preka** shprehet se u mbajt shënim si problematikë dhe do të jemi të angazhuar për të ndërhyrë në këtë rrugë sepse e dimë prioritetin duke qenë se është edhe shkolla pranë dhe banorët e shumtë në atë zonë.

Banor, lagjja “Guerrile”, rruga “Dasho Shkreli”:

- Kemi një rrugë rreth 30 metra, ku nuk është ndërhyrë asnjëherë. Sapo bie shi është e pamundur të kalohet dhe i gjithë uji futet në shtëpitë tona. Ka vite që premtohet por nuk është bërë akoma.
- Kemi edhe disa pemë që janë problematike sepse bien mbi banesat tona. Ju lutem të bëhet krasitje sepse tashmë janë bërë të rrezikshme.
- Tjetër problematikë janë edhe pusetat në zonën tonë, të cilat duhen pastruar.

Sqaron **Z. Salihi** duke thënë se periudha e krasitjeve është dhjetor - janar dhe këtë vit do të fillohet krasitja tek zona e unazës.

Po ashtu edhe administratori **Z. Borshi** shprehet se rruga është e bërë dhe duhet vetëm të bashkohet kjo rrugicë me kanalizimet dhe ujërat e rrugës ekzistuese. Do të vijmë për ta verifikuar këtë situatë menjëherë. Kurse përsa i përket pastrimit të pusetave, duhet të bëhet një kërkesë tek ujësjellësi për pastrimin e tyre dhe do ta ndjekim edhe ne si problematikë.

Z. Denis Zmijani, banor në rrugën “Lopçej”:

- Kemi një rrugicë rreth 70 metra, pas shkollës “10 Korriku”, ku duhet të ndërhyhet me kanalet e ujërave të zeza dhe me asfaltim sepse është kthyer në shqetësim të përditshëm për banorët aty. Është urgjente tani që fillon edhe sezoni i rreshjeve. Ai shton se është banor që prej viteve ‘80 në këtë rrugicë dhe është e vetmja që nuk është asfaltuar kurrë. Po ashtu duhet parë edhe mundësia e ndriçimit të zonës aty.

Përsa i përket ndriçimit sqaron **Z. Borshi** mund të shohim nese mundemi të shtojmë ndriçuesat aty, ndërsa për rrugën do bëjmë të pamundurën për të krijuar mundësinë për të ndërhyrë. Do të vijë një grup punë për të parë në terren mundësinë për ndërhyrje.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka **Z. Alban Preka**, Zv. Kryetar i Bashkisë mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

Zbardhi proces verbalin

Bekim Mema

Irma Sulishti



SEKRETARE

Sabina Danaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË PREZENCË
(Lagjia nr.2)

KONSULTIM PUBLIK: “Për Miratimin e Projektbuxhetit 2026 dhe Programit Buxhetor afatmesëm 2026-2028, të Bashkisë Shkodër”

Date: 18.09.2025

NR.	EMRI MBEMRI	LAGJIA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1.	Eriselda Kotaj	Lagjia "Partizani"	0696730481	kotajeriselda08@gmail.com	
2.	Edona Shpati	Lagjia "Partizani"	0683408272		
3.	Fatmira Hoxhaj	Lagjia "Partizani"	0695425160	fatmirahoxhaj6@gmail.com	
4.	Denis Zmijani	Lagjia Partizani	0692061777	d.zmijani@gmail.com	
5.	Noel Bogromi	Lagjia Partizani	0695277722	noelbogromi201@gmail.com	
6.	Haris Knezi	Lagjia Partizani	0696481848		
7.	Elvis Hysa		0686450288	elvis.hysa@gmail.com	
8.	Arta Keli	Lagjia Gypçev	0676038430		

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJA/SHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
9.	Arben Gjoka	Dërgut	069243231	arben-gj@hotmeil.com	
10.	Doela Qebren	Madon	0676825084	doela@qebren.com	
11.	Domstels kalp	B. Shkoder.	0643570001	domstels@shkoder.com	
12.	David Molecchi	B. SHKODER	0684063501	david.molecchi@shkoder.com	
13.	GENJAN KOLCIS	B. SHKODER	0672671808		
14.	ALTIM PULLI	MTA PP	0682092890	altim@pulli.com	
15.	Adim Shogaj	NSHP	0672626866	adimshogaj@gmail.com	
16.	Vezair Mësim	Partizani			
17.	Arman Dabovic	—			
18.	Idun Shkoder				
19.	Zamir Alijoli				
20.	Maksim Dabovic				
21.	Blerim Dergisi	Gjenerale		BlerimDergisi@gmail.com	
22.	Hasan Kuntisi	Gjenerale	0693462514		
23.	Belkizë Diler	Gjenerale	0674810901		
24.	Xhevdan Aja	Gjenerale			
25.	SHAGJE MINSOLA	Gjenerale			
26.	Ervin Dizdani	koordinator	0694063981		